



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Mars 2022

Nr: 123

V E N D I M

P Ë R

**SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË AMBASADËS TË MALIT TË ZI, PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 4.3.2022, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

**KËRKUES:** Ambasada e Malit të Zi, me seli në Tiranë, Rruga “Abdi Toptani ” dhe përfaqësues z. Danilo Brajovic;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimi nr. 2, datë 2.2.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”

V Ë R E J:

Ambasada e Malit të Zi i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për 1 (një) vëzhgues afatshkurtër si dhe zonën e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Malit të Zi është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.



## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

### V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër të Ambasadës së Malit të Zi në Shqipëri, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

